

ALBARRIA

Vit IV 1900 Rum. 11

Vatikani (pellazi i Papes) ka 11000 oda. Nder keto Luani i XIII mban vëtem tri, ñe te vogel per te pritur boten, ñe te ngushte per te ngreac, é ñe per te fjëtur.

Punojne mi ghithe facé te dhéut 1500 000 punetore per te citur thinghill nga dhëu.

Thone sé Pérandoréshta é Kines, kur udhëton, mér mé vété 3000 pale roba te ndryshma, ci jane ne 600 kutira é shpitéa préj 1200 sherbetoresh.

Printsi i Wales, i biri i Mbréteréshtes Viktorie, paguan 350 lira inglizé per ñe mij tsingaré, te tsilat jane te zghédhura nder me te mirat é botes.

Ne Ghërmanie é ne Hëlvetie, bejne vit per vit 2000000 sy te célcata ; édhé ne Paris ndodhét ñe fabrike é mire ku bejne ñ' a 300 000. Keto sy te célcata u vihëa me téper punetorevé, é me shume atyrevé ci punojne hékurin te tsilevé shpësh u peltsét syri. Rralle eshte te ndodhën gra ci te vene sy te célcata.

Dy Maghare, ZZ. Pollak é Virag ghetne ñe téjshkrim (télégraphie) te ri mé te tsilin

do te mundin te chohén 60 000 fjale per ore, é, pune me é chuditeshmé, keto fjale do te shtypén si ne ñe liber mé te vajtur té vendi ku dergohén.

Ata ci udhëtojne ne dét, kane ndëghuar shume hère fjalen " mil ". Mili s' eshte ñe ne ghithe visét. M' i shkurti eshte mili i Kines, 609 kut, é m' i ghati mili i Norvéjes, 12 182 kut.

Mi ghithe facé te dhéut dalin 42800 gazéta, nder te tsilat 6 050 n' Ingllé, é 743 ne Rusie.

Ñe Lokomotive, a cérré mé tym ci héc cérrét é tjëra n' udhe te hékurta, ka ace fortse sa 900 kuaj bashke.

Mé sy, munt ñëriu te nemeroje ne ciéll 6000 yj. Mé ñe dulbi te fort, munt te shohe 5 000 000 yj per ñe hère.

É katerta pjése é ñëresvé te dhéut vdesin para sé te behën shtate vjëtesh, ghysma para sé te behën shtate-mbe-dhjéte vjëtesh.. Nde ch' do 1000 vétá, ñe vëtem arrin 100 vjëtesh.

VDEKJA É NAIM BÉ FRASHERIT.

Mesuan mé shtrengim zemré vdékjén é te ndriteshmit vjérshetar, é atdhëtarit te madh ci, mé pendë é mé fjale, punoj pa pushuar per te zghear Shciperine. Vdékja é Naim béut eshte ñe zi per kombin t' one. Vdic, po émeri i tij esht i pavdëkur ne zemrat t' ona. Pace é thëlle mi shpirt te tij!

Ne numer ce vjén kémi per te rrefyér sherbimét ce Naim béu i beri Kombit.

ALBANIA.

Kryei i Riollit.



SHUM hérësh préje ñi punét vogel ci nuk shutitét n' é pare pertrihén t' zéza t' mdhaa! Kso dorët céné tui u-pertrii, tash po bahén kater vjét, ngatrrésa t' mdhaa n' ket krah t' Shcypniis, mé shkajk t' ñi Krycit ci cé ngréhe é rrdzué n' Kurté brii Riollit, é punet é atyné t' perzimévé, ci gadi mriiné mé charet nnermjét vllazniin é Shcyptarvé, kan mé mméte n' kohe t' mrame t' shkrué mé nner fléde t' nnollnivé t' Shcypniis.

Ngatrrésat céné pertrii n' ket mnnyre : N' Kurté c' motit ghinnëshin do lédhé t' ñi Kishes rrënuemé me ñi tsope vënn per rréth ci ghith hère éé ñéhe é Kishes préje ghith vënnavé, é ku déri m' tash vone s' kishé gudzué kush mé vûe dore m' te é mé é préke. Tui kéne ajo Kische brii rrugét ku rréh Riollit é ghith Pulti kahe bié n' Shkoder, shum hérësh shtëgtaret é sidomos Pultit nnalëshin brii aso Kishét n' pushim tui bâa t' lutunat é féés vét.

Ajo mennyre frigét ci kaa sé i tsilli Shcypaar si Nuhamédan si i Kshhtëne mé vue dore m' shka t' dihét sé i perkét Ghamiivé é Kishvé, i kishé prite

